



**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 23, datë 23.05.2016

Për

“MIRATIMIN PËR KALIMIN NË ADMINISTRIM PËR SHOQËRINË “UJËSJELLËS – KANALIZIME” TIRANË SH.A”, TË NJË SIPËRFAQEJE TRUALLI FUNKSIONAL, PREJ 3270.41M², BRENDA TERRITORIT TË PRONËS ME NR. 133, ME EMËRTIMIN “SHTABI I REPARTIT USHTARAK NR.8836”, ME NR.PASURIE 354/15, ME VENDNDODHJE NË YZBERISHT, TIRANË, NË PRONËSI TË BASHKISË SË TIRANËS, PËR NDËRTIMIN E NJË DEPOJE UJI, PËR FURNIZIMIN ME UJË TË ZONËS NË UNAZËN E RE, YZBERISHT DHE NË FUSHËN “MISTO MAME”, TIRANË”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.2, shkronjat “a” dhe “c”, nenit 23, pikat 1 dhe 3, nenit 54, shkronja “e”, nenit 55, pikat 4 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, për “Vetëqeverisjen vendore”; nenit 8 të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 për “Pronat e paluajtshme të shtetit” (i ndryshuar); ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 për “Transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr.542, datë 18.06.2015 për “Kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Tiranë, për shoqërinë “Ujësjiellës – Kanalizime”, Sh.a, Tiranë, të një sipërfaqe trualli funksional, prej 3270.41 m², brenda territorit të pronës me nr. 133, me emërtim “Shtabi i Repartit Ushtarak nr. 8836”, me vendndodhje në Yzberisht, Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr 515, datë 18.07.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, (të ndryshuar)”; vendimit të Këshillit Bashkiak, Tiranë Nr. 2, datë 01.03.2012 për “Marrjen në pronësi të Bashkisë së Tiranës të aksioneve të “Ujësjiellës kanalizime”, sha Tirana”; Udhrit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë me nr.18337, datë 17.11.2015 mbi “Ngritjen e grupit të punës për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.542, datë 18.06.2015 për “Kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Tiranë, për shoqërinë “Ujësjiellës – Kanalizime” Sh.a, Tiranë, të një sipërfaqeje trualli funksional, prej 3270.41 m², brenda territorit të pronës me nr.133, me emërtim “Shtabi i Repartit Ushtarak nr.8836”, me vendndodhje në Yzberisht, Tiranë dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.07.2003 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes” (të ndryshuar)”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak:

V E N D O S I:

1. Kalimin në administrim të një sipërfaqeje trualli funksional, prej 3270.41 m², brenda territorit të pronës me nr.133, me emërtim “Shtabi i Repartit Ushtarak nr.8836”, me nr.pasurie 354/15, me vendndodhje në Yzberisht Tiranë, në pronësi të Bashkisë së Tiranës për “Ujësjiellës Kanalizime” Tiranë Sh.a”, për ta përdorur për ndërtimin e depos së

furnizimit me ujë të zonës në Unazën e re, Yzberisht dhe në fushën “Misto Mame”, sipas genplanit bashkëlidhur.

2. Bashkia e Tiranës dhe “Ujësjetllës Kanalizime” Tiranë Sh.a” u ndalohe të ndryshojnë destinacionin e sipërfaqes së truallit funksional të pronës të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojnë apo t’ua japin në përdorim të tretëve.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit dhe shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” Tiranë Sh.a”.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI